

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**PROGRAMI**

**I KURSIT TË UNIFIKUAR**

**PËRPUNIM**  
**FRUTA PERIME**

**Kodi: PK-A-4-21**

Miratoi:

MINISTRI

.....

**Tiranë, 2021**

# **PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR**

## **“PËRPUNIM FRUTA PERIME”**

**(PK-A-4-21)**

### **I. Profili Profesional i përpunuesit të fruta perimeve**

#### **a) Karakteristikat e përpunuesit të fruta perimeve**

Përpunuesi i fruta perimeve është i aftë të kryejë *detyra* profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar në sektorin e Teknologjisë ushqimore.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, përpunuesi i fruta perimeve duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe *shprehi* praktike që lidhen me veprimtarinë profesionale të përpunuesit të fruta perimeve.

Suksesi i përpunuesit të fruta perimeve është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: korrektësia, shkathtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, saktësia, gjakftohtësia, disiplina, etj, sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

#### **b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e përpunuesit të fruta perimeve**

Profesioni i përpunuesit të fruta perimeve është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për prodhimin e reçelit, kompostos, marmalatës, prevedesë, glikosë, marinadave, turshive, lëngjeve të fruta perimeve, koncentreve, vajit të ullirit, frutave dhe perimeve të thara e të ngrira dhe konservave të gatshme dhe gjysëm të gatshme. Ai mund të punësohet ose vetëpunësohet në fabrikat/punishtet e përpunimit të fruta perimeve në industrinë ushqimore që i përkasin kësaj fushe veprimtarie.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e punëtorit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, punëtori mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e teknologut ushqimor. Për të zhvilluar aktivitet privat dhe për vetëpunësim, në veprimtarinë e përpunimit të fruta perimeve, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Përpunues të frutave dhe perimeve”, me kod 7516, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

### **II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Përpunim fruta perime”**

Në përfundim të Kursit “Përpunim fruta perime” kursantët do të jenë të aftë të:

- kryejnë organizime të vogla të punës në repartet e përpunimit të fruta perimeve;
- përdorin dhe interpretojnë kartën teknologjike të përpunimit të fruta perimeve;
- përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet, makineritë, lëndët e para dhe ndihmëse sipas procesit të punës;
- mirëmbajnë mjetet, pajisjet dhe makineritë në mjedisin e punës;
- zbatojnë legjislacionin që ka të bëjë me përpunimin e frutave dhe perimeve.
- prodhojnë konserva natyrore;
- prodhojnë komposto;
- prodhojnë marinadë;

- prodhojnë marmalatë;
- prodhojnë salcë;
- prodhojnë reçel;
- prodhojnë prevede;
- prodhojnë gliko;
- prodhojnë lëngje të turbullta;
- prodhojnë lëngje të kthjellëta;
- prodhojnë vaj ulliri;
- prodhojnë turshi të thjeshta;
- prodhojnë turshi të përziera;
- prodhojnë konserva të gatshme dhe gjysëm të gatshme;
- prodhojnë fruta perime të thara në mënyrë natyrore;
- prodhojnë fruta perime të thara në mënyrë artificiale;
- prodhojnë fruta perime të ngrira;
- zbatojnë rregullat e sigurisë në punë, të higjienës, të ruajtjes së mjedisit dhe dhënies së ndihmës së parë, sipas standardit HACCP;
- zbatojnë standardet e profesionit;
- Kryejnë llogaritje ekonomike për punët e kryera;
- zbatojnë standardet e garantimit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore;
- zbatojnë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit;
- komunikojnë me etikë me eprorët, kolegët dhe klientët;

### III. Kërkesat e pranimit në kursin “Përpunim fruta perime”.

Pjesmarrësit në kursin “Përpunim fruta perime” duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

### IV. Kohëzgjatja e kursit “Përpunim fruta perime”.

**360** orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

### V. Modulet e kursit “Përpunim fruta perime”.

| Nr | Titulli i Modullit                                    | Kodi         | Kohëzgjatja  | Rezultatet Mësimore  |
|----|---|--------------|--|--|
| 1  | Hyrje në profesionin e përpunuesit të fruta perimeve. | MK-08-262-21 | 40 orë mësimore<br>Rekomandohet:<br>80% Teori<br>10% Praktikë<br>10% Vlerësime | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të përpunuesit të fruta perimeve.</li> <li>2. Kursanti përshkruan dhe demonstroi rregullat e sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit.</li> <li>3. Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet, dhe materialet e punës në përpunimin e fruta perimeve.</li> <li>4. Kursanti përshkruan organizimin e punës dhe legjislacionin për përpunimin e fruta perimeve.</li> </ol> |

|   |   |              |   |  |
|---|---|--------------|---|--|
| 2 | Prodhimi i reçelit, glikosë, prevedesë, marmalatës dhe kompostos. | MK-08-263-21 | 100 orë mësimore<br>Rekomandohet:<br>10% Teori<br>80% Praktikë<br>10% Vlerësime | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti prodhon reçel.</li> <li>2. Kursanti prodhon gliko.</li> <li>3. Kursanti prodhon prevede.</li> <li>4. Kursanti prodhon marmalatë.</li> <li>5. Kursanti prodhon komposto.</li> </ol>                |
| 3 | Prodhimi i koncentratit dhe lëngut të frutave e perimeve.         | MK-08-264-21 | 80 orë mësimore<br>Rekomandohet:<br>10% Teori<br>80% Praktikë<br>10% Vlerësime  | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti prodhon lëngje të turbullta.</li> <li>2. Kursanti prodhon lëngje të kthjellëta.</li> <li>3. Kursanti prodhon vaj ulliri.</li> <li>4. Kursanti prodhon koncentrate (salcë) nga perimet.</li> </ol> |
| 4 | Prodhimi i turshive dhe marinadave                                | MK-08-265-21 | 50 orë mësimore<br>Rekomandohet:<br>10% Teori<br>80% Praktikë<br>10% Vlerësime  | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti prodhon turshi.</li> <li>2. Kursanti prodhon marinada.</li> </ol>   |
| 5 | Prodhimi i konservave të perimeve.                                | MK-08-266-21 | 60 orë mësimore<br>Rekomandohet:<br>10% Teori<br>80% Praktikë<br>10% Vlerësime  | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti prodhon konserva natyrore gjysëm të gatshme.</li> <li>2. Kursanti prodhon konserva me perimeve të pjekura me dhe pa shtesa.</li> <li>3. Kursanti prodhon konserva të fërgesave.</li> </ol>        |
| 6 | Prodhimi i frutave dhe perimeve të thara e të ngrira              | MK-08-267-21 | 30 orë mësimore<br>Rekomandohet:<br>10% Teori<br>80% Praktikë<br>10% Vlerësime  | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti prodhon fruta-perime të thara në mënyrë natyrore.</li> <li>2. Kursanti prodhon fruta-perime të thara në mënyrë artificiale.</li> <li>3. Kursanti prodhon fruta-perime të ngrira.</li> </ol>       |

## VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

## VII. Përshkruesit e Moduleve të kursit “Përpunim fruta perime”

### 1. Moduli “Hyrje në profesionin e përpunuesit të fruta perimeve”

| <i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>                                     |  |                     |
|--|--|---------------------|
| <b>Titulli dhe kodi</b>  | <b>HYRJE NË PROFESIONIN E PËRPUNUESIT TË FRUTA PERIMEVE.</b>   | <b>MK-08-262-21</b> |
| <b>Qëllimi i modulit</b>   | Një modul që njih kursantët me veçoritë e profesionit të përpunuesit të fruta perimeve (funksionet, detyrat, veprimtaritë), me mjedisin, mjetet e materialet, me rregullave e sigurisë e mbrojtjes në punë, me dhënien e ndihmës së parë e ruajtjes së mjedisit, si dhe me organizimin e punës dhe legjislacionin për këtë profesion.  |                     |
| <b>Kohëzgjatja e modulit</b>                                     | 40 orë mësimore<br>Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime  |                     |
| <b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>                           | Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç.   |                     |
| <b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b> | <b>RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të përpunuesit të fruta perimeve.</b><br><b>Kriteret e vlerësimit:</b><br>Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës të përpunuesit të fruta perimeve;</li><li>- të përshkruajë mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës së përpunuesit të fruta perimeve;</li><li>- të përshkruajë kërkesat profesionale për përpunuesin e fruta perimeve;</li><li>- të tregojë mundësitë e punësimit të përpunuesit të fruta perimeve;</li><li>- të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të përpunuesit të fruta perimeve;</li><li>- të përshkruajë rregullat e bashkëpunimit dhe komunikimit në mënyrë etike me eprorët, kolegët dhe klientët;</li><li>- të zbatojë rregulla të higjienës personale në punë;</li><li>- të tregojë rëndësinë e zbatimit të detyrave në reparte;</li><li>- të përshkruajë rregullat për garantimin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore (standardi HACCP).</li><li>- të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në industrinë ushqimore dhe Kodit të Punës.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pyetje përgjigje me gojë.</li><li>- Pyetje përgjigje me shkrim.</li></ul> |                     |

**RM 2 Kursanti përshkruan dhe demonstroi rregullat e sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të tregojë rëndësinë e veshjes së uniformës gjatë punës në reparte;
- të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik në repartet e përpunimit të qumështit;
- të përdorë mjetet e mbrojtjes personale në punë;
- të zbatojë manualët përkatëse në përdorimin e pajisjeve dhe makinerive;
- të respektojë sinjalistikën në ambientet e punës;
- të demonstrojë planin e evakuimit në raste emergjence;
- të përshkruajë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- të tregojë rregullat e ruajtjes së distancave të rekomanduara në vendin e punës;
- të përshkruajë rregullat për mbrojtjen ndaj rrymave ose tensionit;
- të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe ndarjes së mbetjeve teknologjike sipas llojit;
- të përshkruajë rregullat për dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti;
- të demonstrojë dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.
- Demonstrim praktik.

**RM 3 Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet dhe materialet e punës në përpunimin e fruta perimeve.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë repartet dhe linjat e prodhimit për përpunimin e fruta perimeve;
- të interpretojë skemat teknologjike të përpunimit të fruta perimeve;
- të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdoren në repartet e përpunimit të fruta perimeve;
- të tregojë llojet e solucioneve larëse dhe dezinfektuesve që përdoren në repartet e përpunimit të fruta perimeve sipas Standardit 3D (higjienizimi, desinsektimi dhe deratizimi);
- të tregojë rëndësinë e kujdesit gjatë përdorimit të solucioneve dhe dezinfektuesve në reparte;
- të përshkruajë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të solucioneve dhe dezinfektuesve në repartet e përpunimit të fruta perimeve;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

**RM 4 Kursanti përshkruan organizimin e punës dhe legjislacionin në përpunimin e fruta perimeve.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë llojet e bizneseve në fushën e përpunimit të fruta-perimeve;
- të përshkruajë format ligjore të organizimit të bizneseve në fushën e përpunimit të fruta perimeve;
- të tregojë organizimin dhe ndarjen e punës gjatë përpunimit të fruta perimeve;
- të përshkruajë legjislacionin e punës për veprimtarinë në fushën e përpunimit të fruta perimeve;
- të përshkruajë kërkesat për licensim të ushtrimit të profesioni të përpunuesit të fruta perimeve;
- të përshkruajë legjislacionin fiskal që i referohet bizneseve në fushën e përpunimit të fruta perimeve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së përpunimit të fruta perimeve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartet e përpunimit të fruta perimeve. Atyre duhet t'i jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit të përpunuesit të fruta perimeve, me funksionet, detyrat, veprimtaritë dhe rregullat ku mbështetet puna e përpunuesit. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
  - Mjedise reale të punës në repartet e përpunimit të fruta perimeve.
  - Mjetet e materialet e përpunimit të fruta perimeve.
  - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara, plane prodhimi, receta, në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

## 2. Moduli “Prodhimi i reçelit, glikosë, prevedesë, marmalatës dhe kompostos”.

| <i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>                                     |   |                     |
|--|---|---------------------|
| <b>Titulli dhe kodi</b>  | <b>PRODHIMI I REÇELIT, GLIKOSË, PREVEDESË, MARMALATËS DHE KOMPOSTOS.</b>  | <b>MK-08-263-21</b> |
| <b>Qëllimi i modulit</b>   | Një modul që aftëson kursantët për të prodhuar reçel, gliko, prevede, marmalatë dhe komposto.   |                     |
| <b>Kohëzgjatja e modulit</b>                                     | 100 orë mësimore<br>Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime  |                     |
| <b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>                           | Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e përpunuesit të fruta perimeve”.  |                     |
| <b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b> | <b>RM 1 Kursanti prodhon reçel.</b><br><b>Kriteret e vlerësimit:</b><br>Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të dallojë lëndët e para dhe ndihmëse, që përdoren për prodhimin e reçelit;</li><li>- të tregojë llojet e reçelit;</li><li>- të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit organo–shqisorë të frutave për reçel;</li><li>- të veshë uniformën, në vendin e punës;</li><li>- të përgatitë vendin dhe mjetet e punës, për prodhimin e reçelit;</li><li>- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e reçelit, sipas rregullave higjieno-sanitare;</li><li>- të lexojë saktë recepturën;</li><li>- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse, sipas recepturës;</li><li>- të kryejë procese përgatitore për prodhimin e reçelit (peshim, seleksionim, larje, heqja e pjesëve të padobishme e coptim);</li><li>- të përgatisë shurupin sipas recepturës;</li><li>- të kryejë etapat e procesit teknologjik për prodhimin e reçelit (blansherim, hedhja e shurupit të sheqerit, zierje, hedhja e shtesave dhe mbikqyrje e procesit të zierjes);</li><li>- të kryejë zbrazjen (shkarkimin) e masës së reçelit të prodhuar nga dublikatori në makinerinë mbushëse/ dozuese;</li><li>- të përgatisë ambalazhi, për ambalazhimin e reçelit;</li><li>- të zbatojë rregullat e ambalazhimit dhe etiketimit të reçelit, për ruajtje;</li><li>- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para, ndihmëse dhe produktit të gatshëm;</li><li>- të transportojë mbeturinat e ndryshme, në vendin e caktuar;</li></ul> |                     |



- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e reçelit;
- të pastrojë dhe mirëmbajë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të reçelit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Kursanti prodhon gliko.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të dallojë lëndët e para dhe ndihmëse që përdoren për prodhimin e glikosë;
- të tregojë llojet e glikosë;
- të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit organo-shqisorë të frutave për gliko;
- të veshë uniformën, në vendin e punës;
- të përgatitë vendin dhe mjetet e punës, për prodhimin e glikosë;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e glikosë, sipas rregullave higjiëno-sanitare;
- të lexojë saktë recepturën;
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse, sipas recepturës;
- të kryejë procese përgatitore për prodhimin e glikosë (peshim, seleksionim, larje, përmasim, heqja e pjesëve të padobishme e coptim);
- të përgatisë shurupin sipas recepturës;
- të kryejë trajtim me tretësira alkaline të frutave (hedhja e frutave në tretësirë për 10-15 minuta, kullimi, shpëlarja me ujë të rrjedhshëm);
- të kryejë etapat e procesit teknologjik për prodhimin e glikosë (hedhja e shurupit të sheqerit, zierje, hedhja e shtesave e mbikqyrja e procesit të zierjes);
- të kryejë zbrazjen (shkarkimin) e masës së glikosë të prodhuar nga dublikatori, në makinerinë mbushëse/dozuese;
- të përgatisë ambalazhin, për ambalazhimin e glikosë;
- të zbatojë rregullat e ambalazhimit dhe etiketimit të glikosë, për ruajtje;
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para, ndihmëse dhe produktit të gatshëm;
- të transportojë mbeturinat e ndryshme, në vendin e caktuar;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e glikosë;
- të pastrojë dhe mirëmbajë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së

shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të glikosë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 3 Kursanti prodhon prevede.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të dallojë lëndët e para dhe ndihmëse që përdoren për prodhimin e prevedesë;
- të tregojë llojet e prevedeve;
- të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit organo-shqisore të frutave për prevede;
- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të përgatitë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e prevedesë;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e prevedesë, sipas rregullave higjieno-sanitare;
- të lexojë saktë recepturën;
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse, sipas recepturës;
- të kryejë procese përgatitore për prodhimin e prevedesë (peshim, seleksionim, larje, heqja e pjesëve të padobishme e coptimi);
- të kryejë etapat e procesit teknologjik për prodhimin e prevedesë (zierja e frutave, përftimi i lëngut të frutave, hedhja e sheqerit, hedhja e shtesave, mbikqyrja e procesit të zierjes e filtrimi);
- të kryejë zbrazjen (shkarkimin) e masës së prevedesë të prodhuar nga dublikatori, në makinerinë mbushëse / dozuese;
- të përgatisë ambalazhin, për ambalazhimin e prevedesë;
- të kryejë ambalazhimin dhe etiketimin e prevedesë;
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para, ndihmëse dhe produktit të gatshëm;
- të transportojë mbeturinat e ndryshme, në vendin e caktuar;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e prevedesë;
- të pastrojë dhe mirëmbajë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të prevedesë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

#### **RM 4 Kursanti prodhon marmalatë.**

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të dallojë lëndët e para dhe ndihmëse që përdoren për prodhimin e marmalatës;
- të tregojë llojet e marmalatës;
- të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit organo–shqisorë të frutave për marmalatë;
- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të përgatitë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e marmalatës;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e marmalatës, sipas rregullave higjieno-sanitare;
- të lexojë saktë recepturën;
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse, sipas recepturës;
- të kryejë procese përgatitore për prodhimin pulpës së frutave për marmalatë (peshim, seleksionim, larje, heqja e pjesëve të padobishme, coptim e zierje);
- të kryejë etapat e e procesit teknologjik për prodhimin e marmalatës (transporti i pulpës në pasirka, pasirimi, hedhja e sheqerit, hedhja e shtesave, mbikqyrja e procesit të zierjes e ftohje);
- të përgatisë ambalazhin për ambalazhimin e marmalatës;
- të kryejë ambalazhimin e marmalatës;
- të zbatojë rregullat e ambalazhimit dhe etiketimit të marmalatë, për ruajtje;
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para, ndihmëse dhe produktit të gatshëm;
- të transportojë mbeturinat e ndryshme, në vendin e caktuar;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike, për prodhimin e marmalatës;
- të pastrojë dhe mirëmbajë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të marmalatës.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

#### **RM 5 Kursanti prodhon komposto.**

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të dallojë lëndët e para dhe ndihmëse që përdoren për prodhimin e kompostos;
- të tregojë llojet e kompostos;
- të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit organo–shqisorë të frutave për komposto;
- të veshë uniformën, në vendin e punës;

- të përgatitë vendin dhe mjetet e punës, për prodhimin e kompostos;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e kompostos, sipas rregullave higjiëno-sanitare;
- të lexojë saktë recepturën;
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse, sipas recepturës;
- të kryejë procese përgatitore për prodhimin e kompostos (peshim, seleksionim, larje, përmasim, heqja e pjesëve të padobishme, coptim e blansherim);
- të përgatisë tretësirën sipas recepturës;
- të kryejë etapat e procesit teknologjik për prodhimin e kompostos (përgatitja e ambalazhit, sistemimi i frutave në ambalazh, hedhja e shurupit të sheqerit, hedhja e shtesave, deajrimi, mbyllja hermetike e sterilizimi);
- të përgatisë ambalazhin, për ambalazhimin e kompostos;
- të zbatojë rregullat e ambalazhimit dhe etiketimit të kompostos, për ruajtje;
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para, ndihmëse dhe produktit të gatshëm;
- të transportojë mbeturinat e ndryshme, në vendin e caktuar;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e kompostos;
- të pastrojë dhe mirëmbajë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të kompostos.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës në repartet e përpunimit të fruta- erimeve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartet e përpunimit të fruta-perimeve.
- Atyre duhet ti jepen detyra për të prodhuar reçel, gliko, prevede, marmalatë dhe komposto. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me makineri, mjete dhe materiale pamore.
  - Mjedise reale të punës në repartet e përpunimit të fruta perimeve për prodhimin reçelit, glikosë, prevedesë, marmalatës dhe kompostos.
  - Mjetet, pajisjet, makineritë /linjat për prodhimin e reçelit, glikosë, prevedesë, marmalatës dhe kompostos.
  - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara, recptura në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

### 3. Moduli “Prodhimi i koncentratit dhe lëngut të frutave e perimeve”.

| <i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>                                     |   |                     |
|--|---|---------------------|
| Titulli dhe kodi   | <b>PRODHIMI I KONCENTRATIT DHE LËNGUT TË FRUTAVE E PERIMEVE.</b>  | <b>MK-08-264-21</b> |
| <b>Qëllimi i modulit</b>   | Një modul që aftëson kursantët për të prodhuar lëngje të turbullta e të kthjellta të fruta perimeve, vaj ulliri dhe koncentratit (salcës) nga perimet.  |                     |
| <b>Kohëzgjatja e modulit</b>                                     | 80 orë mësimore<br>Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime   |                     |
| <b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>                           | Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e përpunuesit të fruta-perimeve”.  |                     |
| <b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b> | <p><b>RM 1 Kursanti prodhon lëngje të turbullta.</b></p> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit organo-shqisore të fruta-perimeve për lëngje;</li> <li>- të tregojë lëndët e para dhe ndihmëse që përdoren për prodhimin e lëngjeve të turbullta;</li> <li>- të dallojë llojet e lëngjeve të turbullta;</li> <li>- të veshë uniformën në vendin e punës;</li> <li>- të përgatitë vendin dhe mjetet e punës, për prodhimin e lëngjeve të turbullta;</li> <li>- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e lëngjeve të turbullta, sipas rregullave higjieno-sanitare;</li> <li>- të lexojë skemën teknologjike të prodhimit të lëngjeve të turbullta;</li> <li>- të kryejë procese përgatitore për prodhimin e lëngjeve të turbullta (peshim, seleksionim, larje, heqje e pjesëve të padobishme e coptim);</li> <li>- të kryejë etapat e procesit teknologjik për prodhimin e lëngjeve të turbullta (ngrohja, presimi, konservimi, ambalazhimi e sterilizimi);</li> <li>- të përgatisë ambalazhin, për ambalazhimin e lëngjeve të turbullta;</li> <li>- të zbatojë rregullat e ambalazhimit dhe etiketimit të lëngjeve të turbullta, për ruajtje;</li> <li>- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para, ndihmëse dhe produktit të gatshëm;</li> <li>- të transportojë mbeturinat e ndryshme, në vendin e caktuar;</li> <li>- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e lëngjeve të turbullta të fruta perimeve;</li> <li>- të pastrojë dhe mirëmbajë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;</li> </ul> |                     |

- 
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të lëngjeve të turbullta.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Kursanti prodhon lëngje të kthjellëta.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të tregojë lëndët e para dhe ndihmëse që përdoren për prodhimin e lëngjeve të kthjellëta të fruta peimeve;
- të dallojë llojet e lëngjeve të kthjellta;
- të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit organo-shqisorë të fruta-perimeve për lëngje;
- të veshë uniformën, në vendin e punës;
- të përgatitë vendin dhe mjetet e punës, për prodhimin e lëngjeve të kthjellëta;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e lëngjeve të kthjellëta, sipas rregullave higjiëno-sanitare;
- të lexojë skemën teknologjike të prodhimit të lëngjeve të kthjellta;
- të kryejë procese përgatitore për prodhimin e lëngjeve të kthjellëta (peshim, seleksionim, larje, heqje e pjesëve të padobishme e coptim);
- të kryejë etapat e procesit teknologjik për prodhimin e lëngjeve të kthjellëta (ngrohja, presimi /centrifugimi, kthjellimi, konservimi, ambalazhimi e sterilizimi);
- të përgatitë ambalazhin, për ambalazhimin e lëngjeve të kthjellta;
- të zbatojë rregullat e ambalazhimit dhe etiketimit të lëngjeve të kthjellëta, për ruajtje;
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para, ndihmëse dhe produktit të gatshëm;
- të transportojë mbeturinat e ndryshme, në vendin e caktuar;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e lëngjeve të kthjellëta;
- të pastrojë dhe mirëmbajë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të lëngjeve të kthjellëta.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

### **RM 3 Kursanti prodhon vaj ulliri.**

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të tregojë vlerat ushqimore të vajit të ullirit;
- të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit organo–shqisorë të ullirit për vaj;
- të dallojë llojet e ullirit për prodhimin e vajit;
- të veshë uniformën, në vendin e punës;
- të përgatitë vendin dhe mjetet e punës, për prodhimin e vajit të ullirit;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e vajit të ullirit, sipas rregullave higjieno-sanitare;
- të lexojë saktë skemën teknologjike të prodhimit të vajit të ullirit;
- të kryejë procese përgatitore për prodhimin e vajit të ullirit (peshimi, largimi i papastërtive, larja e bluarja);
